

## AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË "ZEMAN Z" SH.P.K

Sot më datë 16/10/2024 palët e mëposhtme:

- **Znj. Borana Zemani**, me numër ID J25109054V e datëlindjes 09/01/1992 lindur në Tiranë, dhe banuese në Tiranë.

shprehin vullnetin e tyre për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "ZEMAN Z" sh.p.k si më poshtë vijon:

### 1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria "ZEMAN Z" sh.p.k, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar", shkurtimisht sh.p.k.

### 2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku:

- **Znj. Borana Zemani**, me numër ID J25109054V i datëlindjes 09/01/1992 lindur në Tiranë, dhe banuese në Tiranë.

### 3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "ZEMAN Z" Sh.p.k do të jetë:

- Tregti me shumicë e pakicë e veshjeve dhe produkteve sportive, me porosi online, apo në objekt. Atelier (Rrobaqepsi/Stilim) prodhim dhe shitje veshjesh, aksesorësh mode dhe tekstilësh, me shumicë dhe pakicë; organizim eventesh mode. Çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji.

### 4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë "ZEMAN Z" Sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Njësia administrative Farkë, Nr. Pasurie 104/87-N10, volum 50, faqja 73, zonë kadastrale 3292, Selitë, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

### 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## 6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë).

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

## 7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i shoqërisë “ZEMAN Z” sh.p.k është Znj. Borana Zemani me nr. ID J25109045V.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “ZEMAN Z” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**Ortaku i Shoqërisë “ZEMAN Z” sh.p.k**



**Znj. Borana Zemani**